

VENDIM
Nr.33, datë 16.4.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “SAROLLI” SHPK ME SERI PV03P,
NR.7, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.15,
DATË 27.08.2003**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 pika 4 germa “a” dhe “b” të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008 dhe nenit 18 pika 1, germa “a” të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.03.2009 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.04.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “SAROLLI” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.7, seria PV03P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.15, datë 27.08.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për ndryshimin e licencës me seri PV03P, nr.7, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.15, datë 27.08.2003, të mbajtur nga shoqëria “SAROLLI” sh.p.k.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar NEPRAVISHTA